



UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
"FEHMI AGANI"  
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës  
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/314  
Datë: 06/03/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 12 paragrafi 1 pika 1.15 dhe nenin 17 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani, në mbledhjen e mbajtur më 03.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për hartimin e akteve të përgjithshme normative mbi organizimin, mënyrën e udhëheqjes dhe funksionimit të Qendrës Shëndetësore Universitare të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në këtë përbërje:
  1. Dr. Ismet Bardhoshi-neuropsikiatër, anëtar i KD-së - kryetar;
  2. Ass. Kushtrim Grezda, anëtar i KD-së - anëtar
  3. Prof. Asoc. Dr. Haxhi Kamber, Prorektor për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë – anëtar;
  4. Prof. Asoc. Dr. Idriz Berish, Dekan i fakultetit të Mjekësisë- anëtar;
  5. Linda Dula- Halilabazi, Sekretare e Përgjithshme - anëtare.
- II. Komisioni ka për detyrë të hartojë aktet e përgjithshme normative mbi organizimin, mënyrën e udhëheqjes dhe funksionimit të Qendrës Shëndetësore Universitare dhe t'ia paraqes Këshillit Drejtues për shqyrtim dhe miratim.
- III. Gjatë procesit të hartimit të akteve të përgjithshme normative mbi organizimin, mënyrën e udhëheqjes dhe funksionimit të Qendrës Shëndetësore Universitare, Komisioni duhet të bazohet në Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për Shëndetësi, Statutin e UGJFA-së, dhe aktet nën-ligjore në fuqi.
- IV. Komisioni duhet të konsultohet me Senatin, fakultetet dhe studentët e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi t'i dërgohet:

- Anëtareve të Komisionit;
- Menaxhmentit të UGJFA-së;
- Njësive akademike;
- Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova